



Duke u mbështetur në nenin 17 paragrafi 1 nën pikën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174, Planin Zhvillimor të Komunës 2014-2021 të miratuar me 26.11.2015, Planit Rregullues të Hollësishëm të Komunës së Klinës të miratuar nga Kuvendi i Komunës, më 25.03.2016 dhe me kërkesën 01 Nr.586-5411/18 të dt. 10.08.2018, Kuvendi i Komunës në seancën e IX-të të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më dt.26.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e hapësirës publike për ngritjen e bustit të GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU në qytetin e Klinës

I

Caktohet hapësira publike për ngritje të bustit të GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU në Qytetin e Klinës në shenjë nderimi me rastin e 550- vjetorit të vdekjes së heroit mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti –Skënderbeu.

II

Ngritja e bustit si në pikën 1 të këtij vendimi behët me Kërkesën e Pjesëmarrësve të Tribunës Shkencore VITI MBARËKOMBËTAR i GJERGJ KASTRIOTIT –SKËNDERBEUT dhe Forumit të Intelektualëve “Luigj Gurakuqi” në Klinë, në afërsi të Sheshit “Muji Krasniqi” në krahun e djathtë, në ngastrën 520-2, ZK Klinë, pronë Shoqërore e Kuvendit Komunal Klinë, në sipërfaqe prej 52 m katror në vendin e quajtur Stupovi.

III

Për implementimin e këtij vendimi i rekomandohet Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat konform dispozitave ligjore në fuqi.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës, konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Kryetari, Drejtoria e Urbanizmit dhe MM, Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësi, anëtarët e Komisionit, Zyra Ligjore, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr.586-5411/18
Klinë, më 26.10.2018



Kryesuesi,
Fadi Gash